



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Republika e Kosovës / Republika Kosova  
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica  
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative  
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

Nr./Br. 016101-16664  
Data/Datum 30.07.2020  
Gjakovë - Djakovica-Gjakova /2020

Dt. 30.07.2020

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. Pika (d), nenit 40 pika (J) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 18 të Ligjit nr.04/L-010 Për Bashkëpunim ndër komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.30.07.2020, pas diskutimeve lidhur më pikën e 9-të të rendit të ditës: Themelimi i Nismës për Bashkëpunimin ndër Komunal me Komunën e Pejës, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet NISMA për Bashkëpunimin Ndër Komunal në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës së Pejës .
2. Bashkëpunimin Ndër Komunal në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës së Pejës, do të bëhet në fushën e Zhvillimit Socio- Ekonomik Lokal, Planifikimit më të mirë Rural dhe Urban, Mbrojtje të Mjedisit, Përmirësimin e Infrastrukturës në fshatrat Llugagji në Komunën e Pejës dhe Jabllanicë në Komunën e Gjakovës, duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushën e zhvillimit të turizmit, trashëgimisë kulturore, duke ndikuar në zhvillimi e bujqësisë dhe blegtorisë dhe përmirësimin e jetesës së qytetarëve.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini që ti filloj Konsultimet dhe përgatitjen e Propozim Marrëveshjes për bashkëpunim Ndër Komunal.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
5. Vendimi iu dërgohet:
  - Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
  - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
  - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,  
*Anton Shala*  
Anton Shala